



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**QENDRA KOMBËTARE E KINEMATOGRAFISË**

---

**RAPORT**  
**I**  
**AKTIVITETIT**  
**TË**  
**QENDRËS KOMBËTARE TË KINEMATOGRAFISË**  
**JANAR- DHJETOR 2020**

## **Përshkrim i përgjithshëm i aktivitetit dhe misionit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë (QKK)**

QKK është institucion qendror, që ushtron aktivitetin në zbatim të ligjit nr. 8096, datë 21.03.1996, “Për kinematografinë” të ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të zbatim të tij. Misioni kryesor i QKK është financimi dhe promovimi i prodhimit kinematografik në Shqipëri, nëpërmjet administrimit të fondeve publike, me qëllim zhvillimin e industrisë së filmit në vendin tonë.

QKK, që prej krijimit të saj, mbështet prodhimin, distribuimin dhe promovimin e filmave me metrazh të gjatë, të shkurtër, dokumentar dhe të animuar. Nëpërmjet financimeve prioritet i jepet projekteve që garantojnë bashkëprodhim, kryesisht atyre ndërkombëtar. Kjo është një strategji efikase për të siguruar distribucion dhe audiencë për filmat edhe jashtë vendit.

QKK, gjithashtu, mbështet financiarisht festivale dhe javë filmi, organizon Ditë të Filmit Shqiptar në vende të tjera, seminare, work-shope e konferenca që kontribuojnë në zhvillimin e industrisë së filmit në Shqipëri, si dhe botimin e literaturës kinematografike.

QKK është përfaqësuese e Shqipërisë pranë strukturave ndërkombëtare kinematografike Eurimages, SEE, European Film Promotion, Creative Europe.

Gjatë vitit 2020 QKK hapi 2 sezone konkurimi, pavarësisht situatës së vështirë të krijuar nga pandemia COVID 19. Pas procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të projekteve nga Këshilli i Miratimit të Projekteve, fituan të drejtën për financim 36 projekte.

Më konkretisht:

- 8 projekte për zhvillim projekti të metrazhit të gjatë;
- 7 projekte për filma me metrazh të shkurtër;
- 1 projekt për filma me metrazh të shkurtër të studentëve të Akademisë së Arteve dega Regji Filmi dhe TV- gjithsej 13 filma të shkurtër;
- 7 projekte për filma dokumentarë;
- 3 projekte për filma të animuar;
- 4 projekte për Festivale Filmi
- 2 projekte të ndryshme kinematografike.

Në periudhën Janar - Dhjetor 2020, janë realizuar këto aktivitete dhe financime për projekte kinematografike:

## **I. Xhirime filmash:**

Pavarësisht vështirësive të krijuara nga pandemia globale, u **xhiruan këto projekte filmike:**

- ***Filma artistikë me metrazh të gjatë:***

1. *“Nji prej nesh,”- skenari dhe regjia Ergys Meta.*

- ***Filma artistikë me metrazh të shkurtër:***

1. *“Gjergj,”- regjia Klodiana Keco;*
2. *“Disco Funeral,”- regjia Benard Laze;*
3. *“Filmat temë diplome të studentëve të UA, dega regji filmi dhe tv,, (13 filma të shkurtër);*
4. *“Violinisti,”- regjia Saimir Bajo;*
5. *“Profesionisti,”- regjia Atina Laço;*
6. *“Diel,”- regjia Rain Nikolla;*
7. *“Elena,”- regjia Mateo Cingi;*
8. *“Autobusi 13,”- regjia Orneta Karaj;*
9. *“Kuq e zi ,”- regjia Edmond Mandro;*
10. *“Kadillak dhe manaferra,”- regjia Suela Bako;*
11. *“Ëndrra e një të vdekuri,”- regjia Paskal Semini.*

- ***Filma dokumentarë***

1. *“Bijtë e Kainit,”- regjia Keto Stamo;*
2. *“Arbëreshët,”- regjia Fabian Kati;*
3. *“Mos më harro,”- regjia Ana Shametaj;*
4. *“Në shqipëri dimë ne të zgjedhim...apo thjesht votojmë,”- regjia Pluton Vasi.*

## **II. Premiera Filmash:**

Janë përfunduar dhe kanë realizuar premierat për publikun 10 projekte filmike, si më poshtë vijon:

- **Filma artistikë me metrazh të gjatë:**

1. *“Liqeni im,”- regjia Gjergj Xhuvani;*
2. *“Portreti i pambaruar,”- regjia Namik Ajazi;*
3. *“Shelgu,”- regjia Milco Manchevski- Bashkëprodhim në minorancë*

- **Filma artistikë me metrazh të shkurtër:**

1. *“Gjergj,”- skenari dhe regjia Klodiana Keco, Albana Kozeli;*

2. "Disco Funeral",- regjia Benard Laze;
3. "Filmat temë diplome të studentëve të UA, dega regji filmi dhe tv,, (13 filma të shkurtër);
4. "Profesionisti",- regjia Atina Laço;
5. "Ëndrra e një të vdekuri",- regjia Paskal Semini;
6. "Zë",- regjia Gentian Gjikopulli;
7. "Filmat temë diplome të studentëve të UA, dega regji filmi dhe tv,, (13 filma të shkurtër).

### **III. Festivale ndërkombëtare filmi të organizuara brenda vendit të mbpshtetura nga QKK:**

8. Festivali Ndërkombëtar i Filmit "A-Film Fest Argjiro- Rozafa";
9. Festivali Ndërkombëtar i Filmit dhe Kulinarisë, Pogradec;
10. Festivali Ndërkombëtar i Filmit për të Drejtat e Njeriut "IRHFFA";
11. Festivali Ndërkombëtar i Filmit "TIFF".

### **IV. Projekte të ndryshme kinematografike për vitin 2020:**

1. Projekti "Open Cinema";
2. Edicioni i katërt i "Balkan Film Market,,.

### **V. Pjesëmarrje në festivale ndërkombëtare filmi jashtë vendit:**

1. Stenda e kinematografisë shqiptare në Festivalin e Filmit në Berlin, Shkurt 2020.

### **VI. Projekte të financuara me fonde bashkëprodhimi, fonde evropian, si dhe fonde të IPA II gjatë vitit 2020:**

1. Nëpërmjet programit Interreg IPA Cross-border Cooperation Programme "Italy-Albania-Montenegro", u realizua një pjesë e projektit pilot "Common Initiatives to pRomote CinEma across Italy-Albania-Montenegro". Në përmbushje të këtij projekti u realizuan sa më poshtë:
  - a. Mbështetje financiare të dy festivaleve ndërkombëtare të filmit që zhvillohen në Shqipëri:
    - i. Festivali Ndërkombëtar i Filmit "DEA Film Fest";
    - ii. Festivali Ndërkombëtar i Filmit për të Drejtat e Njeriut "IRHFFA";
  - b. Mbështetje financiare për realizimin e guidës së xhirimit të filmave në Shqipëri.

- c. U realizua procedura e tenderimit publik dhe u blenë aparaturat audiovizive për dy kinematë Gjiroksatër dhe Vlorë, në kuadër të digjitalizimit të tyre.
2. Është financuar nga Eurimages 1 projekt filmik i metrazhit të gjatë “Misioni”, regjia Andi Deliana, ndërkohë që aplikuan gjatë vitit 2020 3 projekte të filmave me metrazh të gjatë;
3. Është financuar nga SEE Cinema Network 1 projekt filmik me metrazh të gjatë- “Sex Cut”, regjia Eno Milkani;
4. U financuan nga Qendra Kinematografike e Kosovës dy projekte e filmave me metrazh të gjatë:
  - a. “Një filxhan kafe dhe këpucë të reja veshur”, regjia Gentian Koçi;
  - b. “Shkëlqimi dhe rënia e Shokut Zylo”, regjia Fatmir Koçi.
5. U realizua projekti “Ditët e filmit shqiptar në "Casa del Cinema", në Romë”, në bashkëpunim me Fondacionin “Occhio blu”, në Itali.

## **VII. Iniciativa ligjore, të ndërmarra në bashkëpunim me institucionet qendrore dhe vendore:**

1. Përgatitja e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8096, datë 21.03.1996, “Për kinematografinë”. Grupi i punës ka përgatitur drafthin e ligjit dhe e ka diskutuar në disa takime. Janë zhvilluar korrespondenca me Ministrinë e Kulturës; Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për këtë qëllim, për të mbledhur informacione në funksion të përgatitjes së faturës financiare që shoqëron këtë projektligj- Shkurt- Dhjetor 2020.
2. U hartua dhe nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit me Universitetin e Arteve, dhe Ministrinë e Kulturës për mbështetjen financiare të projekteve të temave të diplomës së studentëve Dega Regji Filmi dhe TV- Mars 2020.
3. U draftuan dhe miratuan ndryshimet në Rregulloren e Brendshme të QKK, në bashkëpunim të ngushtë me shoqatat e kineastëve- Prill 2020.

## **VIII. Buxheti i QKK për vitin 2020:**

Totali i buxhetit për vitin 2020 ka qenë 147.620.000 Lekë, afërsisht 20 milionë më pak nga viti paraardhës.

Nga ky buxhet 116.220.000 Lekë janë akorduar për mbështetje ekonomike për projekte kinematografike. Realizimi i buxhetit është në masën 100%.

Të ardhurat janë realizuar në masën 943.029 Lekë, të cilat janë derdhur 100% në buxhetin e shtetit. Vihet re ulje në realizimin e të ardhurave, të

cilat kanë qenë si pasojë e mosqarkullimit të filmave, si dhe mbylljes së kinemave për shkak të pandemisë globale.

### **IX. Përzgjedhje dhe konkurime në festivale ndërkombëtare të vitit 2020:**

Numri i paktë i festivaleve të organizuara për shkak të pandemisë globale solli që filmat shqiptarë të përfunduar në vitin 2019-2020 të mos arrinin të përzgjidheshin në konkurim në festivale. Filmat me autorë kosovarë, të cilët kanë marrë mbështetje financiare në kategorinë bashkëprodhim në minorancë që arritën të selektohen në festivale gjatë vitit 2020 janë:

- Filmi Artistik me metrazh të gjatë-vepër e parë “Zana,”- regjia Antoneta Kastrati, u selektua në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Toronto;
- Filmi Artistik me metrazh të gjatë-vepër e parë “Zgjoji,”- regjia Blerta Basholli, u selektua në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Sun Dance dhe u vlerësua me dy çmime.

### **X. Mosrealizime nga objektivat e vitit 2020:**

Për shkak të pandemisë globale nuk u arritën të realizoheshin disa aktivitete të miratuara si më poshtë:

1. Projekti “Festivali i Filmit Shqiptar- Edicioni 14-të”, i cili duhet të organizohej në Tiranë në Tetor 2020.
2. Projekti “Pjesëmarrja e Qendrës Kombëtare të Kinematografisë me pavion në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Kanë, edicioni i 73-të”.
3. Projekti “Ditët e filmit shqiptar në Shkup”, i cili ishte parashikuar të organizohej me iniciativën dhe bashkëpunimin e Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Shkup, Maqedoni.
4. Projekti “Takimi i ekspertëve ndërkombëtarë për konsultimin e ndryshimeve ligjore në fushën e kinematografisë”, i cili do të zhvillohej në Tiranë.